



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2022:135160  
Datë: 24.04.2024  
Numri i dokumentit: 05611190

**K.Dh.Shk.II.nr.361/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë**, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit 1. H.Z. me adresë në rr. “...” nr.17, në Prishtinë, dhe 2. “Europrinty” ShPK me NUI: 810444878, me seli në rr. “...” në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.454/23 të datës 18.07.2023, me datë 23.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e bazuar ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.454/23 i datës 18.07.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.454/23 të datës 18.07.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorëve 1. “H.Z.” dhe 2. “Europrinty” ShPK, dhe ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.514/22, të datës 03.06.2022, i Përmbaruesit Privat Valdrin Beka dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, për shkak të cenimit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, konstatiomit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktvendimi i atakuar të ndryshohet, të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit dhe të refuzohet propozimi i debitorit.

Përgjigje në ankesë nuk kanë parashtruar debitorët.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, me datën 03.06.2022 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorëve 1. H.Z. me adresë në rr. “...” nr.17, në Prishtinë, dhe 2. “Europrinty” ShPK me NUI: 810444878, me seli në rr. “...” në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Urdhëresë për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatore nr.21/001348 e datës 03.02.2022 në vlerë prej 500.00€.

Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit 1. H.Z. 2. “Europrinty” ShPK ka caktuar urdhrin P.nr.514/22 të datës 03.06.2022 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Urdhëresës për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatore nr.21/001348 e datës 03.02.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ja paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumë prej 500.00 €, me kamatë prej 8% në vit duke filluar nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive të borxhit si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.454/23 të datës 18.07.2023/11.05.2023 me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorëve 1. H.Z. me adresë në rr. “...” nr.17, në Prishtinë, dhe 2. “Europrinty” ShPK me NUI: 810444878, me seli në rr. “...” në Prishtinë dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.514/22, të datës 03.06.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Bekaj ashtu që e ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti Urdhëresë për Ndëshkim me Gjobë Mandatore Nr. 21/001348, i datës 03.03.2022, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk përmban tiparet e një vendimi të organit administrativ, i cili mund të këtë cilësinë e dokumentit përmbartues sipas nenit 23 par. 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktapajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër.”* Gjykata vlerësoi urdhrin për përmbartim duke u bazuar në nenin 43 paragrafi 4 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Përmbartuesit privat nxjerrin urdhrin për përmbartueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbartueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj*

*urdhrit të përmbaueshmërisë së nxjerrë nga përmbauesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbaimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbauesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbaimit nga përmbauesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.” dhe gjeti se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbaimit, për shkak se dokumentit mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura e përmbaimit i mungon përshtatshmëria për ekzekutim.*

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar Urdhëresë për Ndëshkim me Gjobë Mandatore Nr. 21/001348, i datës 03.03.2022, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbaimit, e mbi bazën e të cilit Përmbauesi Privat ka lejuar përmbaimitin, nuk përmban tiparet e një vendimi të organit administrativ, i cili mund të ketë cilësinë e dokumentit përmbaues sipas nenit 23 par. 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktpajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër.”*

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se Dhomat e Shkallës së Parë kanë konstatuar drejtë se Urdhëresa për Ndëshkim me Gjobë Mandatore Nr. 21/001348, e datës 03.03.2022 si dokument i besueshëm mbi të cilin ishte iniciuar procedura përmbaimore, respektivisht është lejuar përmbaimiti nuk i plotëson kushtet në mënyrë komulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret është edhe qëndrim i kësaj gjykate se qartë rezulton se i njëjti nuk përmban tiparet e një vendimi të organit administrativ, i cili mund të ketë cilësinë e dokumentit përmbaues sipas nenit 23 par. 2 të LPP-së.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përmbaimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përmbaimore dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përmbaimiti janë tiparet e përmbaueshmërisë së dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga Neni 23 par.2 dhe 43 par.4 i LPP-së. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbaimore duhet ta kenë fuqinë e pa

kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.361/24 dt. 23.04.2024**

**Gjyqtari,**  
**Ramush Bardiqi**